

VENDIM
Nr. 503, datë 24.6.2020

PËR MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË INFORMACIONIT ELEKTRONIK SHËNDETËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 30, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë mënyrën e administrimit të informacionit elektronik shëndetësor.

2. Informacioni elektronik shëndetësor përbëhet nga dokumentet elektronike shëndetësore, që krijohen nga institucionet ofruese të kujdesit shëndetësor, publike dhe jopublike, të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi.

3. Dokumentet elektronike shëndetësore, pjesë të sistemit elektronik të integruar të informacionit shëndetësor, janë si më poshtë vijon:

- a) historiku i gjendjes shëndetësore të pacientit;
- b) receta elektronike/përshkrimi dhe dispesimi në farmaci;
- c) rezultatet e ekzaminimeve laboratorike;
- ç) rezultatet e ekzaminimeve imazherike;
- d) fletëdalja e pacientit nga institucione të kujdesit shëndetësor me shtretër.

4. Dokumentet e përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, aksesohen, si më poshtë vijon:

- a) nga qytetarët, nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*;
- b) nga profesionistët e shëndetësisë për shqyrtimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve, nëpërmjet sistemit përkatës elektronik, në mënyrë të sigurt sipas legjislacionit në fuqi.

5. Aksesimi i dokumenteve elektronike shëndetësore nga mjeku bëhet vetëm me miratimin e pacientit. Formatimi i miratimit të pacientit, që miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, arkivohet pranë mjekut që ofron shërbimin shëndetësor dhe përfshihet në kartelën e pacientit.

6. Shkëmbimi i dokumenteve elektronike shëndetësore do të bëhet nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit nga profesionistët e shëndetit në institucionet ofruese të kujdesit shëndetësor, të cilët regjistrojnë të dhënat shëndetësore të pacientëve.

7. Formatimi dhe përmbajtja e dokumenteve elektronike shëndetësore përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

8. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe të gjithë institucionet e ofrimit të kujdesit shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama